



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:206248
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05838419

Ac.nr.5946/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Nora Bllaca Dula e Halide Reka anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësve K. A, A. Th, S. L, Sh. P, Sh. R, M. M dhe A. M, që të gjithë nga Prishtina, të cilët i përfaqëson D. Z, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, të cilët i përfaqëson Bajram Dili, për kompensimin e pagave për orët e mbajtura mbi normë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3000/2018 të datës 16.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 18.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3000/2018 i datës 16.05.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I, të dispozitivit detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që paditësve K. A, A. Th, S. L, Sh. P, Sh. R, M. M dhe A. M, që të gjithë nga Prishtina, në emër të kompensimit të pagave për orët e mbajtura mbi normë për vitin shkollor 2017/2018 t'ua paguaj shumat e specifikuara si në vijim: paditëses K. A shumën prej 189.36 €, me kamatë ligjore prej 8 % , duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Paditëses A. Th shumën prej 157.80 €, me kamatë ligjore prej 8 % , duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Paditëses S. L shumën prej 278.16 €, me kamatë ligjore prej 8 % , duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e

tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padiësës Sh. P shumën prej 215.98 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padiësës Sh. R shumën prej 399.76 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padiësës M. M shumën prej 399.76 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padiësit A. M shumën prej 246.81 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Në pikën II., të dispozitivit detyrohet e paditura që padiësve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ua paguaj shumën prej 1,636.80 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi shpenzimet e procedurës, me propozim, që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar ose i njëjti të priset dhe të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se padiësit K. A, A. Th, S. L, Sh. P, Sh. R, M. M dhe A. M, kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Prishtinës, me të cilën kanë kërkuar në emër të kompensimit të pagave për orët e mbajtura mbi normë për vitin shkollor 2017/2018 t'ua paguaj shumat e specifikuar si në vijim: padiësës K. A shumën prej 189.36 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padiësës A. Th shumën prej 157.80 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padiësës S. L shumën prej 278.16 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padiësës Sh. P shumën prej 215.98 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padiësës Sh. R shumën prej 399.76 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018,

e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padi tëses M. M shumën prej 399.76 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi. Padi tësit A. M shumën prej 246.81 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 11.10.2018, e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë bëri administrimin e provave, dhe atë: kërkesat e datës 05.06.2018, vërtetimet e SHFMU "...", në Prishtinë, kontratat e punës për padi tësit, lista e pagës për padi tësit dhe ekspertizën financiare të datës 08.12.2021.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: padi tësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratave të punës për stafin arsimor dhe atë padi tësja Sh. R si arsimtare e mësimit klasor, padi tësja Sh. P si arsimtare e mësimit klasor, padi tësja M. M si arsimtare e mësimit klasor, padi tësja S. L si mësuese klasore, padi tësja A. Sh si arsimtare e mësimit klasor, padi tësja K. A si arsimtare e mësimit klasor dhe padi tësi A. M si mësues klasor. Padi tësja K. A, në vitin shkollor 2017/2018, ka punuar me klasat e treta ku ka mbajtur 21 orë mësimore në javë, padi tësja A. Th në vitin shkollor 2017/2018, ka punuar me klasat e treta deri më 30.04.2018, ku ka mbajtur 21 orë mësimore në javë, padi tësja S. L në vitin shkollor 2017/2018, ka punuar me klasat e katërta ku ka mbajtur 22 orë mësimore në javë, padi tësja Sh. P në vitin shkollor 2017/2018 ka punuar me klasat e katërta deri më 20.04.2018, ku ka mbajtur 22 orë mësimore në javë, padi tësja Sh. R në vitin shkollor 2017/2018 ka punuar me klasat e pesta ku ka mbajtur 23 orë mësimore në javë, padi tësja M. M, në vitin shkollor 2017/2018 ka punuar me klasat e pesta ku ka mbajtur 23 orë mësimore në javë dhe padi tësi A. M në vitin shkollor 2017/2018, ka punuar me klasat e pesta prej 01.02.2018 deri më 30.06.2018, ku ka mbajtur 23 orë mësimore në javë. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka vërtetuar se padi tësit kanë punuar mbi normën e orëve mësimore të parapara me kontratat e punës dhe kontratën kolektive dhe atë padi tësja K. A ka mbajtur 1 orë në javë mbi normë, padi tësja A. Th ka mbajtur 1 orë mbi normë, padi tësja S. L, ka mbajtur 2 orë mbi normë, padi tësja Sh. P ka mbajtur 2 orë mbi normë, padi tësja Sh. R ka mbajtur 3 orë mbi normë, padi tësja M. M ka mbajtur 3 orë mbi normë, dhe padi tësi A. M ka mbajtur 3 orë mbi normë prej datës 01.02.2018 deri më 30.06.2018.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur “

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se pretendimet e palës paditëse se me këtë rast nuk është bërë vërtetimi i plotë i gjendjes faktike janë të pa themelta dhe vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykimin, i cili, sipas vlerësimit të Kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestuese.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se me rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë, pasi siç shihet nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga ekspertiza financiare, është vërtetuar se lartësia e kompensimit për paditësit është dhe atë: paditëses K. A, shumën 189.36€, paditëses A. Th, shumën prej 157.80€, paditëses S. L, shumën 278.16€, paditëses Sh. P, shumën 215.98€, paditëses Sh. R, shumën 399.76€, paditëses M. M, shumën 399.76€, paditësit A. M, shumën 246.81€. Ekspertizën e lartcekur kolegji e ka vlerësuar si të drejtë dhe të ligjshme.

Kolegji gjen se në rastin konkret, e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.2 të Ligjit të Punës, ku paditësit nuk kanë realizuar të drejtën e tij sipas dispozitës së nenit 56.2 të Ligjit

të Punës i cili përcakton se: *“Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: 2.1... 20 % në orë për kujdestari, 2.2.... 30 % në orë për punë gjatë natës, 2.3.... 30 % në orë për punë jashtë orarit, 2.4.... 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave, dhe 2.5.... 50 % në orë për punë gjatë fundjavës ”*. Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, përveç kësaj që u theksua si më lartë, baza ligjore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve mbështetet edhe në Kontrata e Punës në nenin 6 të këtyre kontratave ku është parashikuar që *i punësuarit ka të drejtë në pagë shtesë për përqindje të pagës bazë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi*, e gjithashtu edhe në Kontratën kolektive të Arsimit Para universitar të datës 18.04.2017, ku në nenin 11 par 1 të kësaj kontrate është përcaktuar që: *“Ngarkesa mësimore javore për mësimdhënës është 20 orë mësimi në javë ”*, si dhe 35.4 ku thuhet që: *Kur mësimdhënësit dhe punonjësit arsimor kryejnë orë mësimi mbi ngarkesën mësimore vjetore të parashikuar me këtë kontratë, orët mbi normë i paguhen sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi”*. Në një gjendje të tillë të çështjes, kolegji ka aprovuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke refuzuar pretendimet e të paditurës.

Për arsyet e theksuara si më sipër, kolegji gjen se, nuk qëndrojnë pretendimet e palës së paditur se në këtë çështje është bërë aplikimi i gabuar i të drejtës materiale, pasi, gjykata e shkallës së parë me rastin e të vendosurit si në aktgjykimin e atakuar me ankesë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme është bazuar në dispozita ligjore.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5946/2022 më datë 18.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj